NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.
PUBLIC HOUSING ENTERPRISE J.S.C.
Adr: Rr. Bill Klinton pn. Prishtinë-Kosovë
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit:_____ Data: _____

Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit të Punës, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A Prishtinë shpall:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e "Koordinatorit/es të/së ekipeve të mirëmbajtjes në terren" në Ndërmarrjen Publike Banesore - SHA me seli në Prishtinë.

I. Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit/es të/së ekipeve të mirëmbajtjes në terren:

- Koordinon punën e ekipeve të mirëmbajtjes së rregullt në terren;
- Mban evidencën e shërbimit të mirëmbajtjes;
- Bën kontrollimin sistematik të ndërtesave që janë kontraktuar për shërbime të mirëmbajtjes;
- Bën inspektimin e cilësisë së shërbimit të mirëmbajtjes të ofruar nga NPB-ja;
- Mbanë kontakt të rregullt me administratorët e banesave;
- Koordinon punët ndërmjet Qendrës së Thirrjeve dhe ekipeve të mirëmbajtjes;
- Bën pajisjen e punëtorëve të mirëmbajtjes me materialin logjisitik të nevojshëm;
- Përgatit raportet për punët e kryera në terren;
- Kryen edhe punë të tjera me kërkesë të udhëheqësit të divisionit;
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Divizionit të Mirëmbajtjes.

II. Kualifikimi dhe kushtet tjera të veçanta:

- Shkolla e mesme;
- Së paku dy vite përvojë pune;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Në gjendje për të punuar nën presion dhe me orar të zgjatur;
- Njohuri në fushën e mirëmbajtjes;
- Shkathtësi të mira komunikimi dhe negociuese.

III. Procedura e Konkurimit

Kandidati-ja për pozitën "Koordinator/e i/e ekipeve të mirëmbajtjes në terren" duhet t'i dorëzoi këto dëshmi:

- CV-në;
- Letrën e Motivimit;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional;
- Dëshminë për Përvojën e Punës;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit; dhe
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune**.**

Konkursi është i hapur nga data 14.06.2016 – 28.06.2016

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Ndërmarrja Publike Banesore - SHA në Prishtinë, Bulevardi "Bill Clinton", p.nr., Prishtinë** ose përmes e-mailes zyrtare: **burimet.njerezore@npbanesore.com**.
Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.
Kandidatët të cilët konkurojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën.Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.